# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457280**

VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Prokuroria e Fierit godet skemën e dyshuar të pronave në Levan, 2 arrestime dhe qindra mijëra euro të sekuestruara |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/operacioni-per-pronat-ne-fier-lihen-ne-burg-4-persona-ne-hetim-mbi-1143-hektare-toke-dhe-150-mije-euro6543645/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 09:56:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 09:01:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 09:00:00 UTC → 19 shtator 2026, 09:02:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1f3208e97537e993c1f351ef2b4b38611ec733a6e0a39701c10878f51d3b5660` |
| TEKSTI | `745a1517eb647d12ebc86a3166f21e898658a452fa9436611fca389fc59538b7` |
| PAMJA | `58c2613c5f2ff2c05051220717d0ed221e041cf67924dfc66cb96716053b9aa9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `acdd76ac18918f9b56301196a829c4ecca4fbecc88f19d68929a8aa1d7c44229` |
| E MËPARSHMJA | `a83cdd67066e6ca4eddddf0585118352111fb820e496f67ea908fd1f298fd5ed` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/acdd76ac18918f9b56301196a829c4ecca4fbecc88f19d68929a8aa1d7c44229`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | TË FUNDIT

# Prokuroria e Fierit godet skemën e dyshuar të pronave në Levan, 2 arrestime dhe qindra mijëra euro të sekuestruara

19/09/2026 12:35




**Prokuroria e Fierit ka vijuar hetimet për një skemë të dyshuar të përfitimit dhe regjistrimit të kundërligjshëm të pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit.**

Në kuadër të operacionit janë arrestuar ish-drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier, Ertis Shehu, dhe Ervin Habilaj, i dyshuar si përfitues i pronave, ndërsa për një ish-hartograf pranë ASHK-së Fier është caktuar masa "Detyrim për t'u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore".

Hetimet kanë nisur në kuadër të procedimit penal për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Mashtrimi", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Shpërdorimi i detyrës".

Siç raporton gazetarja Anila Hoxha, çështja lidhet me një vendim të vitit 2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që njihte të drejtën e kompensimit për 100 hektarë tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dërmënasit.

Një prej trashëgimtarëve përfitues, Ervin Habilaj, kishte përfituar në vitin 2018 kompensim financiar në vlerën 53.8 milionë lekë. Pavarësisht këtij kompensimi, hetuesit dyshojnë se gjatë vitit 2023 ai ka ndjekur procedurat për regjistrimin e gjashtë pasurive në zonën kadastrale nr. 2436, me sipërfaqe totale rreth 71.7 hektarë.

Nga hetimi janë evidentuar gjithashtu veprime të ish-drejtorit të ASHK Fier, Ertis Shehu, dhe ish-hartografit Emiljano Ruka, lidhur me trajtimin administrativ dhe kadastral të dokumentacionit të përdorur për regjistrimin e këtyre pasurive.

Pas regjistrimit, disa prej pronave dyshohet se janë tjetërsuar përmes shitjes, duke gjeneruar të ardhura në vlera të konsiderueshme. Prokuroria vijon verifikimet për këto transaksione, gjurmimin e vlerave monetare dhe përcaktimin e destinacionit të tyre.

Në kuadër të hetimeve, që drejtohen nga prokurorja Iva Hoxha, janë sekuestruar gjithashtu 715 mijë e 976 euro, të depozituara në llogarinë bankare të Ervin Habilajt. Po ashtu, janë sekuestruar dokumente, pajisje elektronike dhe materiale të tjera që do t'i nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme.

Hetimet vijojnë për dokumentimin e plotë të rrethanave të çështjes, identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë përfshirë dhe individualizimin e përgjegjësisë penale.

**Top Channel**


## Aktualitet »





## Kryesore



Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur
12:59

"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle
08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze
08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin
10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme
11:11

## Më të lexuarat

Rruga Milot-Balldren/ 365 mln euro nën hijen e SPAK, në konsorciumin fitues edhe emra në hetim nga Prokuroria e Posaçme

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratisej

Putini troket në derën e Evropës me "mjetin" gjerman të ekstremit të djathtë/ Moska dhe AfD në të njëjtën tryezë për kthimin e gazit rus në Berlin

Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë të plagosur në gjendje kritike

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga

vendngjarja, reagon policia

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin



**Aksident në Fier-Patos, motoristi i picave mbetet i plagosur pasi u përplas nga një automjet**

19/09 13:02



**Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur**

19/09 12:59



**Dyshohen për përvetësimin e 1143 hektarëve tokë përmes dokumenteve të falsifikuara, ish-drejtuesit e ASHK-së në Fier dalin para gjykatës**

19/09 12:14



**Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia**

19/09 12:08



**Incident me armë zjarri në Tiranë, plagoset lehtë një person. Shpallet në kërkim autori i dyshuar**

19/09 11:56



**Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie**

19/09 10:30

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



**Top News- Gjermania forcon flotën ajrore/ Merr avionin e parë F-35 nga SHBA**



**Top News- Broja e Bajrami jashtë…Maran shpjegon zgjedhjet: Ja pse nuk i thirra**



**Top News- Trump rrit presionin ndaj Putin/ Miratohet projektligji, sanksione më të ashpra ndaj Rusisë**



**Top News- Nations League, Broja e Bajrami jashtë/ Risitë e kombëtares, Maran shpall listën**



**Top News- Shqipëria drejt hapësirës/ I bashkohet marrëveshjeve ndërkombëtare të Artemis**




**Top Channel/ Maran zgjedh 29 kuqezinjtë, kë riktheu dhe kë la jashtë liste**



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.